



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”
REKTORI

Fakulteti i Shkencave Humane, në Universitetin e Elbasanit “Aleksander Xhuvani”, shpall konkurs për 1 (një) pozicion pune personel ndihmësakademik, me kohë të plotë, sekretar mësimit.

Personeli ndihmësakademik, sekretar mësimit, *sekretar mësimit*, është pjesë e sekretarisë mësimore të Fakultetit të Shkencave Humane. Sekretari mësimit, ka përgjegjësi për hedhjen, administrimin arkivimin dhe ruajtjen e të dhënave mësimore të studentëve dhe të procesit mësimit, veçanërisht ka përgjegjësi për plotësimin e regjistrimit bazë të studentëve. Sekretari mësimit bashkëpunon e raporton tek kryesekretarja.

Kandidati/ja duhet të plotësojë këto kritere të përgjithshme e të veçanta.

Kritere të përgjithshme:

- Diplomimi: Të ketë mbaruar studimet universitare të ciklit të dytë (master i shkencave) ose ekuivalente me të. Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura dhe njehsuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.
- Të ketë përvojë të mëparshme pune;
- Të mos jetë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë;
- Të jetë njohës i një gjuhe të huaj perëndimore;
- Ndaj tij të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- Të jetë i aftë për punë.

Kriteret e veçanta të kualifikimit,

- Të ketë njohuri të mira në përdorimin e shqipes standarde, në shkrimin dhe redaktimin e shkresave të ndryshme;
- Të ketë aftësi të mira komunikuese dhe të dijë të bashkëpunojë në grup;
- Të ketë përvojë pune në administratë, përvoja në IAL, përvoja në IAL përbën avantazh;
- Të ketë jetë njohëse dhe përdoruese e kompjuterit dhe progrmeve bazë.

Çdo kandidat duhet të deklarojë se nuk ka konflikt interesi në përputhje me ligjin Nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funkcioneve Publike” i ndryshuar.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”
REKTORI

Kandidatët duhet të dorëzojnë në rrugë postare në Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” brenda 10 (dhjetë) ditëve (**16.12.2024 - 26.12.2024**) nga data e shpalljes në www.app.gov.al dokumentacionin e kërkuar si më poshtë:

- Letër motivimi për pozicionin e punës, sekretar mësimor, në sekretarinë mësimore në Fakultetin e Shkencave Humane në Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”;
- Jetëshkrimin e tij/saj;
- Fotokopje e diplomës e njehsuar me origjinalin. (Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave (Ministria e Arsimit dhe Shkencës);
- Fotokopje e listës së notave e njehsuar me origjinalin. (Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave (Ministria e Arsimit dhe Shkencës);
- Fotokopje e njehsuar e librezës së punës;
- Çertifikata, kualifikime, dëshmi, rekomandime për aftësi të ndryshme, të njehsuara me origjinalin;
- Dëshmi e njohjes së gjuhës së huaj e njehsuar me origjinalin;
- Raport i gjendjes shëndetësore, që vërteton aftësinë për punë;
- Vërtetim i gjendjes gjyqësore;
- Fotokopje e letërnjoftimit;
- Librezë shëndetsore.

Dokumentacioni i kërkuar të dorëzohet në **rrugë postare** brenda 10 (dhjetë) ditëve (**16.12.2024 - 26.12.2024**) nga data e shpalljes në www.app.gov.al në adresën:

Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”,
Rruga “Ismail Zyma”,
Aplikim për pozicionin e punës: sekretar
Elbasan



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”
REKTORI

Konkursi do të zhvillohet në ambientet e Fakultetit të Shkencave Humane. Komisioni ad-hoc do të vlerësojë paraprakisht dosjet e kandidatëve dhe më pas kandidatët do ti nënshtohen intervistës me gojë (3.01.2025 – 11.01.2025). Kandidatët konkurues do të njoftohen elektronikisht për rezultatet paraprake të konkurrimit, orën dhe datën e intervistës dhe për shpalljen/njoftimi i fituesit.